



Pranuar / Doretuar Prilidjenar/Prodato Received/Delivery	27.03.2023	3	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOC	3030/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.350/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Sabile Avdyli - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 350/2023 të datës 13.02.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.350/2023 e datës 13.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 13.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative lidhur me kërkesën e datës 22.12.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve te organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 01.03.2023, ka dërguar përgjigje në ankesë me numër protokolli 2231/2023 së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1691/2023 të datës 13.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë për dhënie e pagës jubilarë e datës 22.12.2022; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e nënshkruar me datë 15.11.2018; Ndryshimi dhe Plotësimi i kontratës i nënshkruar me datë 12.02.2020; Vërtetim i datës 15.12.2011 i lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.03.2023 nga organi i punësimit me numër protokollit 2231/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Ndryshimi dhe Plotësimi i Kontratës i nënshkruar me datën 15.05.2019; Kontratë Pune për kohë të pacaktuar i datës 01.12.2010; Dëshmia se ankuesi ka marrë pagën jubilarë me datë 01.12.2020; E-mail zyrtar i datës 27.02.2023 - Kërkesë për dhënie e pagës jubilarë dhe Vërtetim i datës 01.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është *e pabazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se duhet ti bëhet pagesa e pagës jubilarë bazuar në Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

Ankuesi [redacted] përmes e-mailit zyrtar të datë datës 22.12.2022 ka bërë kërkesë për marrjen e pagës jubilarë, me arsyetimin se ka marrë veç një pagë jubilarë, ndërsa i njëjti punon në Shërbimin Korrektues të Kosovës që nga data 18.09.2000 dhe i ka 22 vite përvojë pune . Menaxheri i Personelit i Shërbimit Korrektues me datën 27.02.2023 i ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e ankuesit me arsyetimin se personeli korrektues i Shërbimit Korrektues të Kosovës kanë qenë të përjashtuar nga shërbimi civil bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, prandaj nuk janë zbatuar as dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve civil ku është e paraparë edhe paga jubilarë. Mirëpo me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësit profesional të Shërbimit Korrektues janë nëpunës civil me status të veçantë, andaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka bërë pagesën e pagave jubilarë varësisht prej përvojës së punës 10 apo 20 vjeçare të nëpunësve, e ankuesit i është bërë pagesa e shpërblimit jubilar për 10 vjetëshin e fundit me datën 01.12.2020, meqenëse për 10 vjetëshin e parë nuk ka pasur bazë ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara nga institucioni punëdhënës, ka konstatuar se ankuesit i është kompensuar shpërblimi jubilar në muajin dhjetor 2020, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se organi i punësimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)"* si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune"*, andaj kolegji i këshillit konstaton se pretendimi i ankuesit është i pabazuar në kuptim të së drejtës edhe për një shpërblim jubilarë për dhjetëvjetëshin e parë të punës nga se organi i punësimit i ka dhënë shpërblimin jubilarë në muajin dhjetor 2020 për dhjetëvjetëshin e dytë

përkatësisht 20 vjetorit të përvojës së punës dhe që argumentohet përmes listës së pagave të muajit dhjetor 2020,ndërsa përveç mungesës së bazës ligjore për dhjetëvjetëshin e parë poashtu edhe kërkesa është jashtë afateve ligjore që parashihen me dispozitat e legjislacionit që ka qenë në fuqi sa i përket realizimit të kësaj natyre të kërkesës.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËSF PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.350/2023, datë 27/03/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

